



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi


KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Maj, 2021

**Kontribut i SBASHK-ut për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim
Rrjedhë e mbarë e trajnimeve të licencuara**



SBASHK-u vazhdon të organizojë aktivitete me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Pasi është marrë aprovimi për 7 trajnime nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, me angazhim të jashtëzakonshëm koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me gjithë stafin në qendër po arrijnë të organizojnë këtë aktivitet duke realizuar kështu kërkesën e qindra anëtarëve të SBASHK-ut ... (faqe 4)

ETUCE në komunikim të vazhdueshëm me sindikatat anëtare
**Sindikatat e Ballkanit alarموjnë ETUCE-n për
vështirësitë e shumta**



Stafi udhëheqës i Komitetit të Sindikatave të Arsimit
të... (faqe 5)

Edhe një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut në shërbim të
anëtarësisë

**Në përpjekje për të përgatitur trajnerë për trajnimin
e ri të licencuar**



Teksa po vazhdohet me organizimin e trajnimeve
të... (faqe 6)

Vazhdon aktiviteti zgjedhor
në SBASHK

**Fushë Kosova, Vitia e Klina
kanë mbajtur Kuvende
zgjedhore**



Pasi që kishin kryer... (faqe 7)

Intervistë me mësimdhënësen
dhe trajneren Esengül Dinovci

**Në SBASHK të gjithë
ndjehemi dhe jemi të
barabartë**



Esengül Dinovci është
mësimdhënëse ... (faqe 3)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Dialogu dhe institucionet



Institucionet e nivelit lokal e qendror duhet të ndjehen mirë kur partnerët e tyre për dialogun social, pra sindikatat, janë mirë të organizuara dhe kanë besimin e të punësuarve në cilin do sektor. Kjo ngase kanë me kë të bashkëbisedojnë e të arrijnë marrëveshje, qofshin edhe të vështira ato, dhe të jenë të sigurt se marrëveshjet do të tumirën.

Mirëpo, mbase jo vetëm në Kosovë, për institucionet nuk është lajm i mirë se një sindikatë është aktive dhe se ka besimin e plotë të të gjithë anëtarësisë dhe jo rrallë,

përfaqësues të institucioneve me deklarata pa as edhe një argument të bazuar mundohen të krijojnë opinion negativ për sindikatat aktive. Kjo nuk është zgjidhje e mirë dhe zakonisht sjell edhe te përplasjet e madje edhe te krijimi i atmosferës plot tensione e që pastaj qojnë edhe në veprime sindikale.

Institucionet qendrore e lokale për të treguar se janë në nivel dhe janë të sigjerta duhet të zgjedhin dialogun si mjet komunikimi me sindikatat dhe të provojnë që përmes takimeve, qofshin ato edhe të mundimshme e me plot përplasje, të kërkojnë zgjidhje të pranueshme për çështjet e ngritura. Deri sa institucionet nuk e kuptojnë këtë realitet atëherë do të përballën me pakënaqësi të arsyeshme e me veprime sindikale dhe pranu a nuk pranu, institucionet ishin dhe janë fajtoret e vetme pse ka pasur e do të ketë protesta e greva.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe trajneren Esengül Dinovci

Në SBASHK të gjithë ndjehemi dhe jemi të barabartë



Esengül Dinovci është mësimdhënëse nga komuniteti turk dhe punon në shkollën fillore “Nazim Kokollari-Budakova”. Krahas angazhimeve të vazhdueshme në procesin mësimor me fëmijë të komunitetit turk, ajo është veprimtare e dalluar sindikale. Ajo lavdëron angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK-ut duke treguar se në sindikatë ndjehen dhe janë të barabartë.

Arsimimi sot

Kush është Esengül Dinovci?

Esengül

Unë jam Esengül Dinovci, jam mësimdhënëse për mësimin klasor e komunitetit turk, në shkollën fillore “ Nazim Kokollari – Budakova” në Prizren. Jam anëtare e SBASHK –ut , ashtu si pjesa më e madhe e punëtorëve arsimor nga komuniteti ynë. Ka kohë që jam veprimtare sindikale dhe jam angazhuar në aktivitete për përgatitjen e trajnerëve dhe se shpejti do të filloj me këtë aktivitet me kolegët nga komuniteti turk.

Arsimimi sot

Si janë kushtet në shkolla për komunitetin turk në Prizren?

Esengül

Kushtet në shkolla ku mësojnë fëmijët e komunitetit turk janë të njëjta me ato për nxënësit tjerë sepse në punojmë në ambientet të njëjta shkollore me kolegët dhe me nxënësit shqiptarë. Ndjehemi shumë mirë dhe kemi bashkëpunim shumë të mirë me kolegët shqiptarë në shkollën tonë. Të gjitha organizimet dhe manifestimet i organizojmë bashkë.

Arsimimi sot

Sa ndikojnë trajnimet në përgatitjen edhe më të mirë të mësimdhënësve për arsim edhe më cilësor ?

Esengül

Është ndjerë në të kaluarën mungesë e trajnimeve për mësimdhënësit të komunitetit turk. Falë mirëkuptimit në SBASHK tani kemi nisur me përgatitjen që dy trajnime të mbahen në gjuhën turke. Trajnimet ndikojnë jashtëzakonisht shumë në realizimin me sukses të procesit mësimor pasi që të gjitha njohuritë e fituara në trajnim i zbatojmë në mësimdhënie dhe për ne si mësimdhënësit janë njohuri që e plotësojnë akoma me shume përgatitjen tone profesionale.

Arsimimi sot

Esenguli si mësimdhënëse dhe si trajnere

Esengül

Unë si mësimdhënëse jam shume aktive dhe shumë e motivuar si dhe mundohem të punoj me metoda me standarde të cilat ndikojnë pozitivisht në arritjen e suksese më të larta në procesin mësimor. Do theksuar se krijohen vështirësi në mungesë të materialeve të mjaftueshme të punës në zbatim të kurrikulit , por ne po angazhohemi dhe po përgatitim materiale në shërbim të procesit mësimor në gjuhën turke. Vlerësoj se profesioni unë është më i miri sepse është një mision në shërbim të dijes dhe njeriu ndjehet krenar kur sheh se ka arritur të përcjell dije e njohuri të reja të nxënësit. Duke pasur mirëkuptimin dhe përkrahjen e SBASHK-ut si trajnere do të mundohem të jap maksimumin në angazhimet për trajnime në gjuhën turke për kolegët mi kudo në Kosovë.

Arsimimi sot

Si anëtare e SBASHK-ut si ndiheni dhe sa keni përkrahje ?

Esengül

Unë si Esengül personalisht kam përkrahje të vazhdueshme nga SBASHK-u dhe mendoj që edhe kolegët e mi kanë të njëjtin mendim si unë ngase me angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK janë realizuar shumë nga kërkesat tona dhe ky përkushtim është duke vazhduar.

Arsimimi sot

Si përfaqësuese e komunitetit turk në Kosovë çfarë këshilloni SBASHK-un?

Esengül

Të organizojë sa më shumë trajnime në gjuhën turke për të ndihmuar kështu mësimdhënësit për arritjen e njohurive të reja dhe që të jenë sa më të përgatitur për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.

Arsimimi sot

Cilat janë pritjet tuaja nga SBASHK-u?

Esengül


Unë mendoj që SBASHK-u është sindikatë me arritje e të larta e në shërbim të anëtarësisë. Jam e bindur se duke ruajtur unitetin e duke bërë angazhime të përbashkëta do të shënojmë arritje e suksese të reja. Le të vazhdohet kështu me angazhime në shërbim të anëtarësisë.

Gjatë muajit


Kontribut i SBASHK-ut për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim

Rrjedhë e mbarë e trajnimeve të licencuara

SBASHK-u vazhdon të organizojë aktivitete me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Pasi është marrë aprovimi për 7 trajnime nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, me angazhim të jashtëzakonshëm koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me gjithë stafin në qendër po arrijnë të organizojnë këtë aktivitet duke realizuar kështu kërkesën e qindra anëtarëve të SBASHK-ut nga e tërë Kosova. Me qëllim që të mos pengohet as edhe një orë mësimi, i tërë ky aktivitet po zhvillohet zakonisht në ditët e vikendit, apo pasditeve të ditëve të punës.




Kështu ishte edhe të shtunën e 8 majit kur nisen me aktivitetin trajnimet, grupet në "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerët Hysen Sogojeva, Safet Beqiri, Burim Avdijaj, pastaj "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm", me trajnerët Atdhe Hykolli, Mjellma Zhara, "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore" me trajneret Zahide Hamiti dhe Pranvera Haziri dhe "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerin Faton Ismajli.




Derisa këto grupe po shënonin ditën e dytë, këtë aktivitet të dielën e 9 majit e kanë nisur pjesëmarrësit në trajnimet "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerin Blendor Shatri dhe grupet me trajnimin "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore"




me trajnerët Ahiret Mehmeti, Hanife Shorra, Arbenita Hajzeri dhe Blerina Haraqija.



Sikur edhe herëve të tjera, edhe kësaj radhe, me pjesëmarrësit e këtij aktiviteti kanë bashkëbiseduar kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, të cilët edhe u janë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve lidhur me angazhimet dhe aktivitetet e shumta sindikale. Kryetari Jasharaj edhe në kuadër të këtyre bashkëbisedave ka shprehur respekt të lartë për angazhimin e përkushtimin e vazhdueshëm të kolegëve tanë në procesin mësimor në këto kushte tepër të vështirësuar nga pandemia, por edhe për entuziazmin që të marrin pjesë në trajnime duke i kthyer kështu vikendet dhe pushimin meritore në ditë pune e angazhimi.



Trajnimet janë duke vazhduar bazuar në kërkesat e shumta të anëtarësisë. Kështu ishte edhe në të shtunën e 29 majit. Kanë nisur këtë të shtunë trajnimet "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajneret Pranvera Haziri, pastaj "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerin Safet Beqiri, "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore" me trajnerët Osman Rustemi, Lutfije Ibrahimli dhe Ahiret Mehmeti.



Pasi janë shtuar shumë kërkesat për trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" SBASHK ka nisur të organizojë edhe këtë aktivitet për mësimdhënësit nga komuna të ndryshme të Kosovës, i cili mbahet në ambientet e institucioneve arsimore. Kështu të shtunën e 29 majit këtë aktivitet e kanë nisur një grup në komunën e

Gjakovës me trajnere Litfana Spahija, një grup në Malishevë me trajnerin Albert Samadaxha dhe të dielën këtë aktivitet e ka filluar edhe një grup me kolegët nga Gjakova me trajnerin Bedrush Zeka. Edhe me pjesëmarrësit e dy grupeve të sotme kanë bashkëbiseduar kryetari Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK Ymer Ymeri.



Kryetari Jasharaj ka përshëndetur kryetarët e nivelit komunal sindikal për Gjakovën dhe Malishevën Sali Maliqi e Skënder Gashi duke i përgëzuar për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë në komunat e tyre .Ai po ashtu ka shprehur respekt meritore për angazhimet e trajnerëve dhe për punën e përkushtuar të kolegëve pjesëmarrës në arsimimin dhe edukimin e brezave, ndërsa koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka bashkëbiseduar me pjesëmarrësit duke u dhënë sqarime për rrjedhën e këtij trajnimi dhe duke u përgjigjur edhe në pyetje , që kishin të bënin me aktivitete e çështje sindikale.



ETUCE në komunikim të vazhdueshëm me sindikatat anëtare

Sindikatat e Ballkanit alarموjnë ETUCE-n për vështirësitë e shumta



Stafi udhëheqës i Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës në krye me presidentin Larry Flanagan dhe drejtoreshën e përgjithshme Suzan Flocken vazhdojnë komunikimin me sindikatat anëtare me qëllim që të jenë të informuar nga afër me situatën aktuale në arsimin e shteteve të Evropës dhe për të dhënë këshilla e mbështetje për të kaluar sa më lehtë nëpër sfidat e shumta të kohës. Ata në kuadër të këtij përkushtimi kanë organizuar një takim pune nga larg edhe me përfaqësues të lartë të sindikatave të arsimit nga shtetet e Ballkanit. SBASHK-un në këtë takim e kanë

përfaqësuar kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe nënkryetarja Vjollca Shala.

Krye-sindikalistët e arsimit nga këto shtete teksa po tregonin për gjendjen në arsimin e shteteve të tyre në kushte pandemie kanë kritikuar institucionet duke dhënë vlerësimin se Qeveritë sikur nuk janë duke e kuptuar gjithë seriozitetin e situatës tepër të vështirësuar e të rënduar në sistemin arsimor e që është krijuar nga pandemia. Krye-sindikalistët nga shtete të Ballkanit kanë kritikuar institucionet edhe sa i takon mungesës së dialogut social duke vlerësuar se dialogu sikur ka rënë në një lloj përgjumje.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë lavdëruar gjithë punëtorët e arsimit në Kosovë për punën e përkushtimin në përballje me sfidat e shumta duke kontribuar në rrjedhën sa më të mbarë të procesit mësimor edhe përkundër kushteve tepër të vështirësuar nga pandemia. Ata kanë treguar edhe për shumë arritje në realizim të kërkesave të anëtarësisë,


Edhe një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë

Në përpjekje për të përgatitur trajnerë për trajnimin e ri të licencuar



Teksa po vazhdohet me organizimin e trajnimeve të licencuara bazuar në kërkesën e anëtarësisë përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal, SBASHK ka nisur të shtunën dhe pas një pune intensive është bërë përzgjedhja e një numri të caktuar kandidatësh, të cilët do të vazhdojnë me punën, përkushtimin dhe përgatitjen që në cilësinë e trajnerëve të licencuar të mbajnë me kolegët nga e tërë Kosova trajnimin e

pjesëmarrja në të gjitha takimet dhe grupet punuese në përgatitje të dokumenteve e strategjive të arsimit në kushte pandemie dhe për angazhimet maksimale në trajnimin e 6000 punëtorëve arsimor me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë.



Presidenti i Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Larry Flanagan ka përgëzuar SBASHK-un për këto dhe shumë angazhime e arritje edhe në këto kohë e kushte për të shprehur gatishmërinë për përkrahje të ETUCE-së për të gjitha sindikatat anëtare. Presidenti Flanagan është shprehur se shqetësimet dhe çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e sindikatave të arsimit nga shtetet e Ballkanit dhe shteteve të tjera në takimet e radhës do të adresohen në të gjitha adresat e institucioneve gjegjëse.

licencuar rishtazi "Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimin Parauniversitar".



Do theksuar se edhe për trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" sa vijnë duke u shtuar kërkesat dhe prandaj është filluar nga stafi qendror të organizohet edhe ky aktivitet. Kështu të dielën e 23 majit kanë filluar dy grupe në trajnimin

"Applikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie". Grupi i parë është duke e zhvilluar këtë aktivitet në ambientet e shkollës "Vëllezërit Frashëri" të Lipjanit udhëhequr nga trajneri Idriz Sopa, ndërsa grupi i dytë në shkollën "Ibrahim Rugova" të Obiliqit me trajnerin Xhelal Krasniqi.

Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka vizituar ambientet e shkollës "Vëllezërit Frashëri" të Lipjanit dhe më vonë edhe ambientet e shkollës "Ibrahim Rugova" të Obiliqit dhe ka parë nga afër angazhimet dhe nismën e mbarë të këtij aktiviteti. Po ashtu në komunikim me pjesëmarrësit është kyçur edhe kryetari Jasharaj, i cili ka përshëndetur kryetarin e nivelit komunal sindikal Emrush Ahmeti, trajnerin Idriz Sopa dhe gjithë pjesëmarrësit në këtë trajnim.



Vazhdon aktiviteti zgjedhor në SBASHK

Fushë Kosova, Vitia e Klina kanë mbajtur Kuvende zgjedhore

Pasi që kishin kryer zgjedhjet në shoqata sindikale, në Fushë Kosovë, Viti e në Klinë janë mbajtur Kuvende zgjedhore të sindikatës sindikale komunale. Ishte një Kuvend i suksesshëm zgjedhor në Fushë Kosovë dhe duke respektuar në tërësi Statutin e SBASHK-ut për garën mes dy e më shumë kandidatëve e përmes votës së fshehtë kryer është zgjedhur Haki Krasniqi. Po ashtu në këtë takim zgjedhor janë zgjedhur me votën edhe pjesëmarrësve edhe nënkryetari, kryesia, përfaqësuesit e kësaj komune në Këshillin Drejtues dhe delegatët për Kongresin e SBASHK-ut. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Ata kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit dhe u janë përgjigjur pyetjeve të tyre e që kishin të bënin me aktivitetin sindikal.



Pas kësaj më 6 maj është mbajtur Kuvendi zgjedhur në Viti. Para këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri të shoqëruar nga kryetari i nivelit komunal janë takuar me nënkryetarin e kësaj komune Hasan Alijaj dhe me drejtorin e DKA-së Basri Aliu. Nënkryetari Alijaj ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet duke vlerësuar lart

bashkëpunimin me kryetarin dhe kryesinë e Kuvendit të sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vitisë. Kryetari Jasharaj ka vlerësuar si shembull shumë të mirë të bashkëpunimit me institucionet komunale të Vitisë me sindikatën, ndërsa koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri i ka informuar mikpritësit për angazhimet dhe aktivitetet aktuale sindikale në nivel qendror e lokal. Me të përfunduar të kësaj vizite kryetari Jasharaj është deklaruar për televizionin lokal lidhur me vizitën dhe për aktivitetet e shumta sindikale.

Pas kësaj ka nisur takimi zgjedhor, të cilin e ka shpallur të hapur kryetari i këtij Kuvendi Kemajl Bislimi, duke përshëndetur fillimisht mysafirët dhe pjesëmarrësit. Nënkryetari i Komunës Hasan Alijaj duke i dëshiruar sukses të plotë këtij Kuvendi ka kujtuar bashkëpunimin e sinqertë të institucioneve komunale me SBASHK-un dhe ka përgëzuar gjithë të punësuarit në arsimin e kësaj komune për punën dhe përkushtimin në arsimimin dhe edukimin e brezave.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar kryetarët e shoqatave për zgjedhjen e tyre dhe ka shpalosur angazhime të shumta sindikale nëpër gjithë këto vite duke shtuar se kryetari Bislimi, kryesia dhe veprimtarët tjerë sindikalë kanë qenë shembull shumë

i mirë i punës , përkushtimit dhe arritjeve. Ai ka shprehur respekt të lartë edhe për koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymerin dhe për gjithë stafin qendror, të cilën, krahas punëve të shumta e të përditshme , po angazhohen maksimalisht edhe në realizimin e trajnimeve të shumta dhe të aktiviteteve tjera në shërbim të anëtarësisë. Në vazhdim të këtij takimi zgjedhor kryetari Kemajl Bilimi ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar për katër vite , të cilët janë aprovuar nga pjesëmarrësit e këtij takimi.

Në pjesën e dytë të këtij takimi në një konkurrencë të fortë mes dy e më shumë kandidatëve të propozuar përmes votës së lirë janë zgjedhur udhëheqësit dhe përfaqësuesit e këtij Kuvendi në organet qendrore të SBASHK-ut. Kryetar është rizgjedhur Kemajl Bilimi kurse nënkryetare është zgjedhur Makfirete Zuka. Përmes votës së lirë janë zgjedhur edhe anëtarët e Komisionit mbikëqyrës, përfaqësuesit nga Vitia për Këshillin Drejtues dhe delegatët për Kongresin e

Kuvend zgjedhor edhe në Klinë

Vlerësohet lart angazhimi i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë

Një atmosferë e veçantë entuziazmi e përkushtimi ishte edhe të premten e 7 majit në Klinë. Para se të niste me punimet Kuvendi zgjedhor, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, me kryetarin e nivelit komunal Arif Elezaj dhe nënkryetarin Islam Kalludra janë gjendur në ambientet e komunës dhe janë pritur nga kryetari prof.dr. Zenun Elezi dhe nënkryetari Besim Hoti.



Kryetari i Klinës prof. dr. Zenun Elezi ka përgëzuar SBASHK-un për punën dhe përkushtimin duke qenë gjithmonë zë i fuqishëm i anëtarësisë dhe ka treguar edhe për bashkëpunimin dhe angazhimet e përbashkëta të tij e institucioneve komunale me udhëheqësit sindikal në këtë komunë, bashkëpunim , i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pavarësisht se

SBASHK-ut. Në mbyllje të këtij takimi pjesëmarrësit në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin e vazhdueshëm në shërbim të anëtarësisë kanë dominuar edhe për një mandat kryetarin e tashëm të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj.



kush do të jenë të zgjedhurit në Kuvendin e sotëm zgjedhor sindikal në këtë komunë.



Kryetari Jasharaj ka deklaruar se ndjehen të nderuar me këtë mikpritje dhe është shprehur me respekt të lartë e meritë për bashkëpunimin mes sindikatës sonë dhe kryetarit, drejtorit të DKA-së dhe institucioneve tjera të qeverisjes në Klinë. Kryetari i SBASHK-ut ka vlerësuar lart edhe angazhimin e përkushtimin e kolegëve të tij Arif Elezi e Islam Kalludra, por edhe të gjithë kryesisë dhe veprimtarëve të tjerë sindikalë në këtë komunë. Vlen të përmendet se dëshmi e respektit të ndërsjellë është edhe mbajtja e takimeve të tjera sindikale dhe të Kuvendit zgjedhor në sallën e takimeve të Asamblesë komunale.



Në hapje të Kuvendit zgjedhor të sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Klinës, kryetari i kësaj Kuvendi Arif Elezaj ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe gjithë pjesëmarrësit duke përcjellë edhe përshëndetjen dhe fjalët e respektit të kryetarit të Komunes prof. dr. Zenun Elezi për ta dhe gjithë të punësuarit në arsim.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përshëndetur të pranishmit duke u treguar fillimisht për mikpritjen dhe përmbajtjen e takimit me kryetarin dhe nënkryetarin e komunës dhe duke shprehur respekt edhe punën dhe angazhimin e vazhdueshëm të kryetarit Arif Elezaj, nënkryetarit Islam Kalludra, kryesisë dhe veprimtarëve të tjerë duke shtuar se Klina është shembull shumë i mirë i aktivitetit sindikal. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime për rrjedhën e mbarë të procesit zgjedhor dhe është përgjigjur pyetjeve të disa prej pjesëmarrësve e që kishin të bënin me çështje sindikale.

Pas kësaj kryetari i Kuvendit të sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Klinën, Arif Elezaj ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar, që janë aprovuar njëzëri nga pjesëmarrësit e këtij takimi zgjedhor. Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor dhe në një garë mes shumë kandidatëve e me votën e lirë e të fshehtë kryetar është rizgjedhur Arif Elezaj e nënkryetar Islam Kalludra.

Janë zgjedhur me votë të lirë e të fshehtë edhe anëtarët e Komisionit mbikëqyrës, delegatët e Kongresit dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut nga kjo komunë.

Rrjedhë e mbarë e një aktiviteti të veçantë të SBASHK-ut

Po përgatiten trajnerë për një trajnim të ri të licencuar

Pas një aktiviteti intensiv katër ditor janë përzgjedhur kandidatët e mundshëm për t'u bërë trajnerë të trajnimit të ri të licencuar të SBASHK-ut "Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimin Parauniversitar". E premtojta e 28 majit ka shënuar ditën e parë dhe pjesëmarrësit janë duke bërë gjithë të mundurën për të marrë njohuri shtesë dhe për t'u përgatitur sa më mirë që detyrën e trajnerit ta kryejnë me sukses.



Në hapje të këtij aktiviteti kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i përgëzuar për punën dhe përkushtimin në procesin arsimor edhe përkundër kushteve shumë të vështirësuar nga pandemia dhe për entuziazmin e treguar në aktivitetin katër ditor të përgatitjes fillestare

për punën e vështirë dhe sfidat e shumta që e presin çdo trajner. Ai ka falënderuar për angazhimin trajnerët Agim Hasani e Hysen Sogojeva duke u shprehur të sigurt se ata edhe gjatë gjithë kohës sa zgjat ky aktivitet do të japin maksimumin në mënyrë që pjesëmarrësit të jenë sa më të përgatitur për detyrën prej trajneri. Kryetari Jasharaj ka shprehur kënaqësinë që mes nesh është edhe prof. Agim Hasani nga Bujanovci.

"Në takimin në SBASHK me prof. Agimin dhe deputetin e nderuar Kamberi kemi premtuar se do të shtojnë bashkëpunimin me kolegët tanë nga Bujanovci, Presheva e Medvegja dhe ja ky është hapi i parë konkret, i cili do të shoqërohet edhe me shumë aktivitete bashkëpunimi sindikal e arsimor me kolegët tanë nga e tërë Kosova Lindore. Jasharaj ka shprehur respektin meritore për deputetin Kamberi, i cili është bërë zë i fuqishëm i gjithë shqiptarëve. Jasharaj ka shprehur respekt meritore për angazhimet e zyrtares për trajnime Albina Arifi, për stafin qendror dhe në veçanti për koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, që krahas shumë angazhimeve ditore në SBASHK, po bëjnë maksimumin duke kthyer ditët e

vikendit në ditë pune me qëllim që edhe ky aktivitet i rëndësishëm për anëtarësinë të ketë rrjedhë të mbarë dhe të realizohen në tërësi objektivat e përcaktuara.



Pas kësaj koordinatori për organizim të brendshëm ka dhënë sqarime lidhur me këtë aktivitet dhe ka prezantuar agjendën, që është e ngjeshur, por si ka thënë ai, do të realizohet në tërësi, qoftë edhe duke e zgjatur orarin e aktivitetit, për çka pjesëmarrësit janë pajtuar duke thënë se këtu janë për të realizuar me sukses të plotë këtë aktivitet ngase duan të jenë plotësisht të përgatitur dhe të dalin faqebardhë në cilësinë e trajnerëve.

Profesori Agim Hasani ka shprehur respekt të lartë për angazhimet dhe gjithë arritjet e SBASHK-ut duke u

shprehur i lumtur se i është dhënë mundësia që të jetë pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm sindikal e arsimor. Ai ka thënë se bashkëpunimi sindikal dhe arsimor është shumë i rëndësishëm dhe ky bashkëpunim do të pasurohet në të ardhmen.

Pas kësaj është nisur me realizimin e agjendës dhe që në fillim është vërejtur përkushtimi i pjesëmarrësve, të cilët janë shprehur se duhet mund e angazhim, por ata do të japin gjithë kontributin për realizimin në përpikëri të objektivave dhe për t'u përgatitur sa më mirë për detyrën prej trajneri.



EI në takime nga larg me përfaqësues të sindikatave anëtare

Për kushte më të mira të punës në arsim



Për aktivitetet e caktuara që Internacionalja Botërore e Arsimit po zhvillon me gjithë sindikatat anëtare nga e tërë bota për gazetën e muajit maj "Arsimimi sot" shkruan kolegja jonë Shqipe Dubovci.

Me ftesë të Edukimit Internacional, si anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK, mora pjesë në takimin e dytë online i cili u mbajtë me datën 25.05.2021. Sikurse edhe takimi i parë i këtij niveli, ashtu edhe ky takim për shkak të rrethanave të Pandemisë Covid-19, u mbajt virtualisht përmes platformës ZOOM. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të arsimit, anëtarë të Edukimit Internacional, nga vende evropiane dhe vende të Ballkanit Perëndimor, si dhe vendeve nga kontinente tjera të cilat sollën përvojat e vendeve të tyre lidhur me rolin e sindikatave dhe krijimin e një klime mjedisore të përshtatshme për mësimdhënie, ku roli i sindikatave është i

vazhdueshëm dhe në qendër institucionale. Në mesin e shumë pikave të rendit të ditës së një agjende të ngjeshur, vend të rëndësishëm në diskutim zuri edhe pika mbi strategjitë për avokim kombëtar për të promovuar ndryshimin e klimës si pjesë e fushatës dhe kontribut nga anëtarët në aktivitetet e parashikuara. Referues nga vende të ndryshme të Evropës dhe më gjerë, pasqyruan përvojat e mira të organizimit sindikal; dhe rolit të tyre në vendet e tyre. Në mesin e shumë folësve prezantuan znj. Robeca Ragent, e cila prezantoi rolin e sindikatave në Zelandën e Re për parimet, mbështetjen e mësimdhënësve dhe si the punën tjetër arsimore në shkollat fillore edhe ato të mesme.

Në vazhdim prezantoi edhe z. Eduardo Bias i cili solli përvojën

meksikane, ndërsa z. Miguel Duhalde nga CETRA solli përvojën argjentinasë.

Po ashtu në këtë takim u diskutua edhe lidhur me Konferencën Botërore të UNESCO në arsimimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke u fokusuar në të drejtat e fëmijëve për pranimin e një klime cilësore të arsimimit, si dhe rolin e qeverisë në zbatimin e një klime cilësore arsimore, marr për bazë llogon e kësaj konference "Mëso për Planetin, Vepro për Qëndrueshmëri".